



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 10 NËNTOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 10
NOVEMBRA 2008. GODINE

NËNTOR - NOVEMBAR

2008

R e n d i i d i t ë s

1. Shqyrtimi i dytë i Grupit të shtatë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

- 1.1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, nr. 03-L-045,
- 1.2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, nr.03-L046,
- 1.3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 2003/14, dhe
- 1.4. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Kodit doganor dhe të akcizave të Kosovës.

D n e v n i r e d:

1. Drugo razmatranje sedme Grupe nacarta zakona iz Predloga Martti Ahtisaarija, po posebnom postupku:

- 1.1. Drugo razmatranje Nacrta Zakona o izmenama Zakona o Ministarsvo bezbedonosnih snaga Kosova, br. 03-L-045,
- 1.2. Drugo razmatranje Nacrta Zakona o izmenama Zakona o bezbedonosnim snagama Kosova, br. 03-L-046,
- 1.3. Drugo razmatranje Zakona o prostornom planiranju, br. 2003/14, i
- 1.4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o carini i akcize na Kosovu.

A g e n d a:

1. Second reading of the seven't Group of the Draft Laws from the Martti Ahtisaari's Proposal, based on the Special procedure:

- 1.1. Second reading of the Draft law on amendment of the Law on Ministry of Kosovo Security Force, no. 03-L-045,
- 1.2. Second reading of the Draft law on amendment of the Law on Kosovo Security Force, nr.03-L046,
- 1.3. Second reading of the Draft law on amendment of the Law on Spatial Planning, nr. 2003/14, and
- 1.4. Second reading of the Draft-Code of Kosovo Customs and Excise.

Seancën e kryesoi Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Ju njoftoj se në sallë janë 80 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Që në fillim ju njoftoj se në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe të legjislacionit të ndërlidhur me të sipas procedurës së veçantë, datë 15 shkurt 2008, në seancën e sotme plenare do të procedohet me shqyrtimin e dytë të projektligjeve të miratuara në parim në seancën plenare të mbajtur më 7 nëntor 2008.

Rendi i ditës, së bashku me rekomandimet e Komisionit ad-hoc, u është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit ad-hoc ta marrë fjalën. E ka fjalën deputeti Ramadan Gashi.

RAMADAN GASHI: I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni ad-hoc, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës, të datës 15 shkurt 2008, në mbledhjen e mbajtur më 10 nëntor 2008, shqyrtoi projektligjet e grupit të shtatë nga propozimi Marti Ahtisarit, të propozuara nga Qeveria dhe Kuvendit vendosi t'i paraqet këtë

R A P O R T

Sa i përket Projektligjit të parë për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Komisioni unanimisht vendosi të përkrahë Ligjin pa ndryshime dhe i rekomandon Kuvendit ta miratojë.

Po ashtu, sa i përket Projektligjit të dytë – për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Komisioni njëzëri përkrahi propozimin e Qeverisë dhe i rekomandon Kuvendit ta miratojë, pa ndryshim.

Sa i përket propozimit të tretë të Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor, po ashtu Komisioni njëzëri u pajtua t'i rekomandojë Kuvendit aprovimin e këtij ligji me një ndryshim të nenit 22, që ka të bëjë me sa vijon: Fjala “pas publikimit” të zëvendësohet me fjalën “ditën e publikimit”.

Për pikën e katërt të propozimit për Projektkodin doganor dhe të akcizave të Kosovës, Komisioni me 7 vota “për”, asnjë “kundër” dhe me 1 abstenim vendosi që t'i rekomandojë Kuvendit miratimin e këtij Projektkodi me një ndryshim.

Neni 8 pika 1 ndryshohet, si vijon:

“Gjatë kryerjes së detyrës, të gjithë oficerët doganorë janë të obliguar të mbajnë uniformën e dallueshme dhe kartelën identifikuese zyrtare të doganës. Për operacionet e veçanta, kur e kërkon natyra e punës, drejtori gjeneral mund të lejojë ndryshe”.

Në fakt, as këtu nuk ka ndonjë ndryshim substancial, por vetëm si riformulim dhe për dallim nga neni ekzistues, Komisioni mendon se është më e qartë kjo formë. Ju faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Faleminderit! Të lajmëruar nuk kemi. Në rend dite do të thotë është pika e parë:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës**

Dëgjuat raportuesin e Komisionit ad-hoc. Tani shkojmë në procedurën e votimit për ligjin e parë – Ligjin për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 79 vota “për”, 2 “kundër” dhe 4 “abstenime”, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin e Ligjit për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ju faleminderit!

Në sallë kemi 89 deputetë.

Vazhdojmë me:

- **Shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës**

Më parë dëgjuam rekomandimin nga përfaqësuesi i Komisionit.

Të lajmëruar për diskutim, nuk kemi, prandaj do të kalojmë në procedurë të votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 82 vota “për”, 1 “kundër”, 4 “abstenime”, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin e Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ju faleminderit!

Në radhë kemi pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikimin hapësinor

Të lajmëruar për diskutim, nuk kemi. Lidhur me këtë, sipas raportit, kemi një amendament.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 74 vota “për”, 3 “kundër”, 10 “abstenime”, Kuvendi miratoi amendamentin 1.

Tani do të shkojmë në procedurën e votimit në tërësi të Ligjit për planifikimin hapësinor.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 69 vota “për”, 4 “kundër”, 13 “abstenime”, Kuvendi miratoi Ligjin për planifikimin hapësinor.

Në radhë është pika e katërt e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektkodit doganor dhe të akcizave të Kosovës

Kryetarët e grupeve parlamentare nuk kanë vërejtje në këtë projektkod, kurse të tjerët edhe nuk kanë të drejtë në këtë.

Edhe këtu kemi një amendament.

(Ndërhyrje)

Shefat e grupeve, sikur që e dini, në mocion, kanë të drejtë. Nuk po bëjmë ndryshime, sepse ishin edhe dy deputetë nga PDK-ja dhe nuk ua dhashë fjalën, prandaj vetëm shefat e grupeve parlamentare kanë të drejtë të marrin fjalën. Faleminderit.

Amendamenti 1 në Projektkodin doganor dhe të akcizave të Kosovës.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 61 vota “për”, 4 “kundër”, 11 “abstenime”, Kuvendi miratoi amendamentin.

Tani do ta votojmë Ligjin në tërësi të Projektkodit doganor dhe të akcizave të Kosovës.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, 12 “kundër”, 6 “abstenime”, Kuvendi miratoi Projektkodin doganor dhe të akcizave të Kosovës. Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë, konstatoj se me kaq i përfundon punimet seanca e sotme plenare.

Mirupafshim në seancën e ardhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve